REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
Qeveria e Kosovës - Vlada Kosova - Government of Kosova
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit Ministarstvo Kulture, Omladine, Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sports
Ref.Nr. 4985 / 2017
Data / Datum / Date 12.12.2017
Nënshkrimi / Potpis / Signature
PRISHTINË, PRIŠTINA, PRISHTINA

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
***Qeveria – Vlada – Government***
**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta / Ministry of Culture, Youth and Sports**

---

**Datë: 07.12.2017**

Në mbështetje të nenit 53, paragrafit 3, dhe nenit 80B të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-222, Ligjin Nr. 04/L-116, Paragrafi 1.4 të Rregullores Nr. 02./2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dhe Vendimit Nr. 05/89 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e datës 25.05.2016, nenit 8 të Rregullores mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve dhe Thirjes Publike për mbështetje financiare të projekteve/programeve të OJQ-ve për zhvillimin e shkathtësive për punësimin e të rinjve, bazuar në Vendimin Nr. 2341/2017 për formimin e Komisionit për vlerësimin e projekteve të paraqitura nga OJQ-të, Komisioni Vlerësues nxjerr këtë:

# VENDIM

1. Në përputhje me detyrat dhe afatet e Komisionit të përcaktuar me vendimin e lartëpërmendur dhe duke u bazuar në Thirrjen Publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve për zhvillimin e shkathtësive për punësimin e të rinjve të datës 19.10.2017, Komisioni ka shqyrtuar dhe vlerësuar të gjithë dokumentacionin përkatës, të dërguar nga OJQ-të, ku sipas kritereve komisioni nuk ka nxjerr asnjë fitues për subvencionim.

ARSYETIMI

Komisioni brenda afatit të përcaktuar me Planin e Veprimit ka bërë hapjen dhe vlerësimin e çdo aplikacioni. Në fazën e parë në bazë të kritereve formale nga 30 (tridhjetë) aplikacione asnjëra prej tyre nuk i ka plotësuar kriteret formale.

Në përputhje me detyrat dhe afatet e komisionit të përcaktuar me planin e punës të miratuar nga të gjithë anëtarët e komisionit, Komisioni ka shqyrtuar të gjithë dokumentacionin përkatës, duke vlerësuar secilin projekt propozim veç e veç sipas thirrjes publike të datës 19 Tetor 2017.
Nga kjo, komisioni ka konstatuar se nga gjithësej 30 (tridhjetë) aplikacione asnjëra prej tyre nuk i plotëson kriteret specifike sipas Rregullores MF-Nr 04/2017 dhe nuk kualifikohen për mbështetje financiare.

**Udhëzim Juridik:** Kundër këtij vendimi lejohet anëkesë në afatë prej 5 ditësh, nëpërmes arkivës së MKRS-s.

**Anëtarët e Komisionit Vlerësues:**
Kryesuesi i komisionit
**Kreshnik Xharra** ____________________ (nënshkrimi)
(emri dhe mbiemri )

Anëtarët e komisionit
**Burim Mexhuani** ____________________ (nënshkrimi)
(emri dhe mbiemri )

**Shqipe Rrahmani** ____________________ (nënshkrimi)
(emri dhe mbiemri )

**Liridona Zymeri, përfaqësuese nga KVRL - Vushtrri** ____________________ (nënshkrimi)
(emri dhe mbiemri )

**Kastriot Luma, përfaqësues nga Kuvendi i të Rinjëve të Kosovës** ____________________ (nënshkrimi)
(emri dhe mbiemri )